



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIVJAKË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Divjakë, më _____._____.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje kancelarie për nevojat e Bashkisë Divjakë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 30125120-8
Toner per makianat fotokopjuese, (CPV): 30197643-5 Leter fotokopjuese, (CPV):22816100-4
Bllok shenimesh, (CPV):22816300-6 Bllok me letra shenimesh me ngjitese, (CPV): 22852000-7
Dosje, (CPV):30190000-7 Furnizime dhe pajisje te ndryshme zyre, (CPV):30199230-1 Zarfa.

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 024 824 (dy milion e njëzetë e katër mijë e tetëqind e njëzetë e katër) lekë pa Tvsh, nga e cila: 833 333 (tetëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh nga Granti dhe 1 191 491 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa Tvsh nga Të ardhurat.

Burimi i financimit:

- 83 333 (tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh nga Granti Spektori Pyjor
- 83 333 (tetëdhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa Tvsh nga Granti Spektori i MZSH-së
- 666 667 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa Tvsh nga Granti Arsimi Parashkollor (Kopështi)
- 1 191 491 (një milion e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa Tvsh nga Të ardhurat Bashkia Divjakë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Divjakë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 77, 82 dhe 83 të LPP dhe nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimit bazuar në natyrën e kontratës, si edhe preventivin, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia e prokurimit gjykon vendosjen e kriterëve si vijon:

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Sipas Shtojcës 7, pika 1 ”Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit”

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, si edhe në nenin 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

(Shënim: përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga administrata tatimore për xhiron e realizuar në 3 (tre) vitet e fundit 2020, 2021 dhe 2022 nga shoqëria, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 1, pika 2 germa c dhe pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 43 të VKM Nr.285/2021 ”Kërkesat për kapacitetet ekonomiko financiare”, pika 1 citon: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, ndersa në piken 2/c citohet: 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”, ndersa në piken 3 citohet: Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor, për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses

kontraten. Gjithashtu vendosja e kriterëve në referencë është bërë që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43 pika 1, pika 2 germa c dhe pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në Ligjin Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në republikën e shqipërisë” i ndryshuar, si edhe në Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontraten.

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, germa c, të Nenit 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter kualifikues, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontraten.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetimet që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2022.

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuar për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Kjo kërkesë është bërë në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës që po prokurohet.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vlera e kërkuar është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme si dhe përvojën e duhur, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën e cilësisë ISO 9001:2015 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)

(Certifikata si më sipër, duhet të paraqitet origjinale ose kopje e noterizuar, e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, pika 1 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 44, pika 1, të VKM nr.285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit,*, si edhe në Ligjin nr.116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet se Çertifikatat duhet të jenë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që AK të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Në lidhje me kërkesën që OE ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatën e standartit si ISO, është menduar se ky është një kriter i domosdoshëm për natyrën dhe vlerën e kontratës, të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit dhe në propocion me të, me qëllim garantimin e realizimit në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standarteve ndërkombëtare të objektit të kontratës. Disponimi i ISO-s rrit kompetivitetin, besueshmërinë dhe performancën e subjektit tregtar në treg, ndaj duke qenë se janë të lidhura ngushtësisht me objektin e prokurimit dhe nuk kufizojnë konkurrencën, OE duhet ta paraqesin atë.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë një deklaratë, që merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi, në ambjentet e AK, nga nënshkrimi i kontratës sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.

Argumentim: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane të deklaratave, për të garantuar përbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhenia e sigurisë AK-se që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë me anë të një deklaratë, se tonerat e kërkuar sipas preventivit, duhet të kenë garanci jo më pak se një vit nga momenti i furnizimit.

Argumentim: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane të deklaratave, për të garantuar përbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhenia e sigurisë AK-se që kontrata do të realizohet sipas kërkesave të përcaktuara në DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të deklarojë me anë të një deklarate, se tonerat do të jenë bojra origjinale ose ekuivalente, me pullë sigurie, të pahapura dhe jo të rimbushura.

Argumentim: Në bazë të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si edhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë me ane te deklaratave, për te garantuar permbushjen me sukses te kontrates nga OE dhe dhënia e sigurise AK-se qe kontrata do te realizohet sipas kerkesave te percaktuara ne DST. Në bazë, të nenit 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.*

Shënim: Autoretiti /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.3. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i mallrave	Specifikime teknike
Bojë printeri / Bojë fotokopje (zërat 1 - 23 të preventivit)	Për sa i përket bojrave të përcaktuara në preventivin e mësipërm për printerat/fotokopjet që AK Bashkia Divjakë disponon, tonerat duhet të jenë bojra origjinale ose ekuivalente, me pullë sigurie, të

	pahapura dhe jo të rimbushura.
Leter A3	<p>Letrat të jenë origjinale dhe të cilësisë së parë. Të jetë CIE bardhësi 169 ± 3, dimensionet: 297x420mm. Pesha e një fije të jetë 80 gr/m² dhe një rizme (500 fije x A4), Lagështira: 3.5-4.5 %. Trashësia: 104-112µm. Drita : $\geq 94\%$. Shkelqimi : 101-114%, Të mos jete e ricikluar, Letra të ketë mbështjellje kundër lagështirës. Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in. Të qëndroje e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit. Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit. Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët. Të plotësojë standartet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë.</p>
Leter format A4 80gsm, (210mm x 297mm)	<p>Letrat të jenë origjinale dhe të cilësisë së parë. Të jetë CIE bardhësi 169 ± 3, dimensionet: 297x210mm. Pesha e një fije të jetë 80 gr/m² dhe një rizme (500 fije x A4), Lagështira: 3.5-4.5 %. Trashësia: 104-112µm. Drita : $\geq 94\%$. Shkelqimi : 101-114%, Të mos jete e ricikluar, Letra të ketë mbështjellje kundër lagështirës. Letra të mos bllokojë makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in. Të qëndroje e rrafshët pas printimit apo fotokopjimit. Të mos lëshojë pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit. Të jetë e përshtatshme për printim në të dyja anët. Të plotësojë standartet që letra të mbahet për kohë të gjatë në arkivë.</p>
Regjistër korespondence (Protokolli) (100 fq)	Hartuar sipas nenit 19 te NORMAVE TEKNIKO PROFESIONALE DHE METODOLOGJIKE TE SHERBIMIT ARKIVOR NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE , modeli 1 (duhet te jete e shkruajur me cdo flete)
Dosje me mekanizëm	<p>Kjo dosje me mekanizëm shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentet duke i kapur me mekanizëm. Ajo duhet të ketë një mekanizëm metalik, i cili i mban dokumentat të mbërthyer me anë të dy shufrave dopjo në të cilat vendosen letrat A4 pasi janë hapur vrimat përkatëse me hapëse vrimash dopjo ose qeset mbajtëse përkatëse. Gjithashtu, duhet të ketë një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Materiali te jete polipropilen me shkelqim. Te jete</p>

	lehtesisht elastike. Të mbajë jo më pak se 600 fletë me gramaturë 80gm ² .
Dosje arkive me buton 15 cm	Dosje me buton me thellësi 15±0.5cm, material polipropileni. Kjo dosje me buton shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentet tuaja të rëndësishme. Gjithashtu, ajo ka një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Përmasat 240±5mm x350±5mm. Mundesisht te kete nje vrime e cila lejon terheqjen e saj sa me lehte nga arkiva.
Qese plastike Dokumenta A ₄ 40 micro (100copë/pako)	Pako me 100 qese plastike prej materiali polipropilen, transparente dhe me madhësi A ₄ , me spesor jo më pak se 100 mikron. Këto qese mund të përdoren me të gjitha llojet e lidhësve të unazave si një mënyrë për të mbrojtur dhe renditur dokumentet. Çdo qese të ketë kapacitet mbajtës jo më pak se 40 fletë A ₄ 80gm ² secila.
Letër Plastike (Transparent) A ₄ (100 fije/pako)	Letër Plastike/kapak PVC transparent A ₄ me trashësi jo më pak se 200 mikron. Paketimi në pako 100 copë.
Letër (Transparent) A ₃ (100 fije/pako)	Letër Plastike/kapak PVC transparent A ₃ me trashësi jo më pak se 200 mikron. Paketimi në pako 100 copë.
Letër Kartoni A ₄ (270 gr) (100 fije/pako)	Letër/kapak kartoni A ₄ me masë 270 gm ² me ngjyra të ndryshme. Paketimi në pako deri në 100 copë.
Kapëse letrash mesatare metalike 24/6	Makina për kapse aktesh (Stapler), të jetë metalike dhe me material çelik i pandryshkshëm ose i kromuar në formë pince (dore). Makina të jetë përshtatshme për të kapur deri në 30 fletë.
Kapse letrash e madhe (deri ne 100 flete)	Makinë kapëse aktesh prej materiali metalik. Makina të jetë përshtatshme për të kapur deri në jo më pak se 100 fletë të gramaturës 80 gr/m ² . Gjithashtu ajo duhet të kapi dhe me pak fleta në varësi të përdorimit duke ndërruar numrin e telave. Te kete depozite per te vendosur telat. Çdo informacion shtesë për numrin e telave që përdoren në varësi të fletave duhet të jenë të shpjeguara dhe në trup të produktit. Telat te jene nga 23/6 deri 23/24.
Kapëse letrash e vogel pince nr 10	Makina për kapse aktesh (Stapler), të jetë metalike dhe me material çelik i pandryshkshëm ose i kromuar në formë pince (dore). Makina të jetë përshtatshme për të kapur deri në 20 fletë.
Tela/kapëse 24/6	Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të

	cilësisë së lartë, te galvanizuar dhe të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Të jenë prej metali të kromuar ose të pandryshkshëm. Te kapi deri ne 30 flete. Paketimi 1000 copë.
Tela/kapëse 23/10	Kapëset/tela të jenë të dizajnuara me material të cilësisë së lartë dhe te galvanizuar, të jenë parashikuar për të shpuar pastër përmes fletëve të shumta të letrës pa u këputur ose shqyer letrën. Te kapi deri ne 70 flete. Paketimi 1000 copë.
Mprehëse lapsash	Mprehës lapsash me dy vrima dhe me depozitë për ashklat e mprehura, po ashtu edhe me gome. Për lapsa deri në Ø11 mm dhe kënd mprehës te ndryshem. Thikat e mprehjes të jenë metalike të kromuara ose metal i pandryshkshëm.
Kapse flutur 25mm (12 copë/pako)	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë.
Kapse flutur 32 mm (12 copë/pako)	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë.
Kapse flutur mm 41mm (12 copë/pako)	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Ngjyra e zezë.
Korrektor (Zbardhues) stilo	Korrektor në formë stilolapsi që shërben për korrigjimin e gabimeve të bëra gjatë shkrimit. Siguron mbulim të mirë dhe thahet shpejt duke lënë një shtresë të butë mbi të cilën mund të shkruhet sërish.
Stilolapsa ngjyra të ndryshëm	Stilolaps i tipit ballpoint me majë 0.7mm-1mm. Të mos krijojë ngecje apo rrjedhje boje gjatë shkrimit.
Bojë vule	Bojë vule blu për të gjitha llojet e vulave. Bojë e pastër mjedisore dhe shumë rezistente. Jo toksike. Paketimi në shishe plastike jo më pak se 20ml.
Goma	Gomë universale për fshirje lapsi dhe boje. Të jetë e bërë nga materiali gome e bute (jo PVC), e pershtatshme për të fshire dhe njollat me të theksuara të lapsit dhe bojës. Nuk duhet të lerë shenja dhe grimca në fletë pas përdorimit. Pa ftalate dhe lateks.
Lapsa plumbi	Lapsi prej grafiti të jetë i prodhuar nga materiale sintetike, që do të thotë se nuk lëshon cifla në rast se thyhet, si dhe të jetë rezistent ndaj shtypjes dhe përdorimit. Shkalla e grafitit të jetë HB. Lapsat te jene jo toksik.

Mbajtëse dokumentash metalike 3 - she	Mbajtëse dokumentash metalike 3 kate, ngjyrë e zezë, me përmasa 36±1cm x 28±1cm x 30±1cm. Ajo shërben për të vendosur dokumentat e përdorimit të përditshëm dhe është e përshtatshme për zyra. Të jetë tërësisht metalike dhe shumë e qëndrueshme.
USB 8GB	PORT 3.0
Makine llogaritese 12 shifra	Makinë llogaritëse tavoline me jo më pak se 12 shifra të shfaqura në ekran. Ekran i madh me pjerrësi të rregullueshme. Burim energjie me bateri dhe diellore. Me opsion Tax+ dhe Tax, po ashtu edhe me opsion për kembimin valutor. Zgjedhje rrumbullakimi dhe presje dhjetore. Fikje automatike.
Vizore alumin (mm) 50 cm	Vizore me gjatësi 50 cm prej materiali metalik (alumin) dhe rezistente që nuk thyhet. Te kete kellefin e vet.

**** Shënim: Në respektim të nenit 36 të LPP-së, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj”.***

Specifikimet teknike u hartuan nga specialistet e fushes, duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, ne perputhje me percaktimet e Nenit 36 “Specifikimet teknike” te Ligjit Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, e Nenit 40 pika 2, si edhe te Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, Neni 12, Neni 13 dhe Neni 76.

NJËSIA E PROKURIMIT